

## THIRRJE TERMAT E REFERENCËS

<b>Organizata</b>	Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara - Handikos Ferizaj
<b>Titulli</b>	Ekspert/e apo Kompani
<b>Lloji i konsulencës</b>	Individuale ose Kompani
<b>Lokacioni</b>	Ferizaj, Kosovë
<b>Kohëzgjatja</b>	Tetor 2022 – Tetor 2023 (19 ditë angazhim)
<b>Data e fillimit (kur pritët)</b>	Tetor 2022

### Handikos Ferizaj

Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare e përkushtuar në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe avokimit. Handikos Ferizaj punon për së afërmi me komunitetin, organizata të tjera si-motra, institucionet shëndetësore dhe autoritetet lokale e qendrore, për t'i shërbyer në mënyrë sa më efektive dhe të qëndrueshme përfituesve të saj.

Handikos Ferizaj, që nga muaji shtator 2022 ka filluar implementimin e projektit **“Përfshirja sociale dhe parandalimi i përjashtimit social të personave me aftësi të kufizuara”** që ka për qëllim përfshirjen e interesave të personave me aftësi të kufizuara në politikat lokale përmes hartimit të planit të veprimit për shërbimet sociale në Komunën e Ferizajt, i cili financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Suedia), Qeveria e Dukatit të madh të Luksemburgut dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

### Qëllimi i përgjithshëm i Konsulencës

Handikos Ferizaj, si organizatë që punon në mbrojtje të, të drejtave dhe interesave të personave me aftësi të kufizuara, synon edhe rritjen e angazhimit të grupeve të interesit në politikë-bërje, planifikim buxhetor në nivel lokal dhe përbushjen e përgjegjësisë ligjore të qeverisjes lokale lidhur me sigurimin e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara. Për këtë arsyeje, po kërkojmë një Ekspert/e apo Kompani i/e cili/a do të jetë përgjegjës/e për hartim të pyetësorëve, fasilitim të fokus grupeve, punëtorive, trajnimeve dhe hartimin e planit të veprimit për shërbimet sociale të personave me aftësi të kufizuara në komunën e Ferizajt.

### Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Hartimi i pyetësorëve për intervista me ofruesit e shërbimeve (OJQ-të, Institucionet relevante) në komunën e Ferizajt;
- Realizimi i fokus grupeve (Persona me aftësi të kufizuara, fëmijë me aftësi të kufizuara dhe prindër/kujdestarë të PAK-ve);
- Përgatitja e raportit me gjetjet kryesore dhe rekomandimet;

- Përgatitja dhe fasilitimi i një (1) trajnimi dy (2) ditor me grupin punues të Planit të Veprimit në fushën e të drejtave të PAK dhe shërbimeve sociale;
- Përgatitja dhe fasilitimi i një (1) punëtorie tre (3) ditore për hartimin e planit të veprimit për shërbime sociale për personat me aftësi të kufizuara;
- Përgatitja e planit të veprimit për shërbimet sociale për PAK në komunën e Ferizajt.

### **Kualifikimet dhe eksperiencia**

- Diplomë Universitare në shkencë sociale, juridik apo fushë të ngjashme (e preferuar)
- Përvojë paraprake në trajnim, analizë dhe mbledhjen e të dhënave, me tematikë të ngjashme;
- Njohuri të çështjes së aftësisë së kufizuar në kontekstin vendor;
- Shkathtësi të larta hulumtuese në identifikimin e praktikave/modeleve të cilat përdoren në rajon dhe botë në këtë fushë;
- Shkathtësi ndër personale dhe të komunikimit;
- Ndjeshmëri ndaj kontekstit dhe situatave të ndryshme me qasje të hapur ndaj diversitetit.

### **Aplikuesit duhet të dorëzojnë**

- Një draft propozim mbi metodologjinë e punës për këtë angazhim, përfshirë koston financiare të kalkuluar për ditët e angazhimit;
- Një letër interesi që paraqet arsyet që ai/ajo është/i/e përshtatshëm dhe ka njohuri dhe eksperiencë në fusha të ngjashme;
- Curriculum Vitae (CV);
- Certifikatë Biznesi (për kompaninë).

### **Kohëzgjatja dhe pritjet**

- Eksperti/e apo Kompania, do të angazhohet për një periudhë prej nëntëmbëdhjetë (19) ditëve, gjatë periudhës **një vjeçare**.
- Angazhimi do të bëhet me faza gjatë gjithë implementimit të projektit dhe do të jetë në dakordim të plotë mes palëve të përfshira.

### **Pagesa**

Pagesa për Ekspert/e apo Kompani do të bëhet sipas përfundimit të përgjegjësive të kontraktura, varësisht nga ditët që është angazhuar.

### **Procedurat e aplikimit**

Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike në e-mail adresën: [handikosferizaj@gmail.com](mailto:handikosferizaj@gmail.com) me subjektin *Aplikoj për "Ekspert lokal"*, Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është **09.10.2022 ora 23:59h**.

Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të kontaktohen. Gjatë gjithë procesit nuk ofrohen informata me telefon.